

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ 2Real ” sh.p.k.

Në Tiranë, sot me datë 27/01/2021, (dymijë e njëzetë e një), unë i nënshkruari : **Ronaldo BAJO**, i biri i Izetit, i datelindjes 30.09.1997, lindur ne Durrës dhe banues ne Tiranë, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit ID Nr J70930075G,

me cilësinë e “Ortakut Themelues”, redaktoj këtë akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklaroj se me vullnet të lire të plotë e të sinqertë, dhe iniciativen e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, me ndryshimet përkatëse, në ligjin “Për QKR”, në Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijoj shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin “ 2Real ” sh.p.k.

KREU I

Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “ 2Real ” sh.p.k.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria “ 2Real ” sh.p.k., është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”), e themeluar nga personi fizik i sipërpërmendur, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për



detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në, Durrës, Rruga "E Lalëzit", Radë , Manëz , Durrës Zona Kadastrale 206/5 me Nr Pasurie 28/47/1

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

Objekti

Ndertimi, projektim dhe zbatim, projektim e ndertim te objekteve te ndryshem civile, industriale, turistike, bujqesore etj, restaurime te godinave e objekteve te ndryshme private, social-kulturore, te kultit etj, punime dhei e transport, punime murature, betoni, beton arme te zakonshem, konstruksione metalike e druri, punime shembjesh, instalime e paisje te nevojshme si dhe shitblerje te materialeve te ndertimit, eksport import, kryerje te transaksioneve te ndryshme te cdo malli(prodhime te ndryshme te gatshme, gjysem te gatshme e lende te pare), duke siguruar dhe sherbime magazinimi per te tretet ne ambjentet e shoqerise, transporte te ndryshme, perdonimi i mjeteve te mekanizuara per punime te ndryshme, me rrota gome e zinxhiri, marrje dhe dhenie me qira te objekteve te ndryshme si dhe cdo veprimtari tjeter qe vecmas ose se bashku me ato te permendura me siper do te konsiderohen te pershatashme per rritjen dhe zhvillimin e shoqerise. Mirembajtje rrugore rutine dhe dimerore. Grumbullim, ruajtje, transportim dhe trajtim i mbetjeve urbane dhe mbetjeve inerte te parrezikshme.

Tregtim import eksport me shumice e pakice te mallrave ushqimore e bujqesore industriale te materialeve, investime ne fushen e ndertimeve civile industriale rikonstruksione te çdo lloji punime te ndryshme ndertimore rikonstruksione.

Tregtim import, eksport me shumice e pakice. Tregtim te mallrave te konsumit, produkt te gatshem, industrial, ushqimor, bimore dhe shtazore.

Tregtim, import eksport me shumice e pakice. Tregtim te materialeve elektrike, hidraulike, ndertimore, izoluese, kimike, termike etj.

Tregtim, import, eksport me shumice e pakice. Tregtim te materialeve pastrimi, detergjente, materiale higjeno sanitare dhe dezinfektimi.



Tregtim, import eksport me shumice e pakice. Tregtim i mallrave industrial, artikujve sportive dhe aksesore ndihmes. Tregtim te materialeve shkollore, kancelarie dhe paisje zyrash.

Tregtim, import eksport me shumice e pakice. Tregtim te materialeve te buta per hotele, spitale, burgje etj.

Tregtim dhe riparim per artikuj mobilerie (Nje game te gjere artikujsh) per hoteleri, zyra, spitale, shkolla dhe ndertime civile .

Tregtim te materialeve kopshtarie, lule, peme dekorative, plehra kimike dhe farera.

Tregtim te materialeve per IT dhe sisteme vezhgimi me kamera.

Tregtim te materialeve pjese kembimi per automjete, mjete buqesore, industri si dhe paisje teknologjike.

Tregtim riparim, sherbin, paisje ngrohjeftohje (kaldaja, kondicioner dhe aspirim) dhe lavanterie.

Riparim, sherbin, tregtim te ndryshme per paisje elektrike, elektromekanike, elektromjeksore, pompa, ashensore etj.

Sherbime dezifikimi 3D ne ambjente brendeshme dhe jashtme.

Sherbime si fotokopjime, skanime, kartvizita, postera, kartolina, kalendare, karta identifikuese etj.

Sherbime, organizime te ndryshme kulturore, sportive, edukuese, promovuese, udhetime turistike etj gjithashtu mund te bashkepunoje me shoqeri te tjera me objekt te njejte ose te ndryshem te saj.

Tregti me shumice e pakice materiale laboratorike, materiale, kimikate e reagente laboratorike, industriale, energetike, mjeksore, veterinare, medikamenteve dhe lendeve te para per prodhimin e tyre.

Tregti me shumice e pakice lubrifikante te ndryshme.

Tregti me shumice e pakice materiale, paisje e aksesore per saldime te llojeve te ndryshme.

Investime ne energetike ,telekomunikacione ,makineri, mallrat e ndryshem, import - eksport produkte dhe sherbime ne industri si energjetika, hidraulika.

Mirembajtje, sherbime e pjese kembimi te makinerive, paisjeve dhe aparaturave, makinerive, aparatura qe perdoren ne sistemin energjetik.

Tregti me shumice e pakice te paisjeve elektronike kompjutera, fotokopje telefona e tjere.

Materiale dhe aksesore elektrik, mekanik, hidraulik, ndertimi per riparime dhe mirembajtje te ndryshme.


Materiale dhe pajisje higjieno-sanitare.

Materiale dhe aksesor saldimi per riparime dhe mirembajtje te ndryshme.

Vegla dhe aksesor pune.

Shtypshkrome dhe fotokopjime te ndryshme.

Pajisje si kompjutera, fotokopje, kondicionere dhe aksesor e pjese kembimi per riparime, mirembajtje dhe sherbime te paisjeve te ndryshme si kompjutera, fotokopje, kondicionere dhe te se njejes natyre ose te ngashme.



Rimbushje e fikseve te zjarrit.

Materiale dhe sherbime specifike si pastrime, dezinfektime, deratizime dhe te tjera te ngjashme.

Pjese kembimi, sherbime e mirembajtje per makineri dhe aparatura qe perdoren ne fushen e energjitetes.

Lubrifikante si adblue, antifrise, graso, elektolit, alkool frenash dhe te ngjashme ose te se njejetes natyre.

Pjese kembimi per automjete te tipeve te ndryshme, goma dhe te ngjashme ose te se njejetes natyre.

Materiale dhe kimikate te ndryshme per analiza kimiko-fizike te ndryshme.

Riparim, sherbim, tregtim te peshoreve te Mallrave dhe sendeve te llojeve te ndryshme si dhe Peshime te Mallrave dhe sendeve te llojeve te ndryshme.

Tregtim me shumice e pakice te pajisjeve kompjuterike, skanerave diagnostikues per makina, aparatura e pajisjeve dhe vegla pune, per servise automjetesh.

Tregti me pakice dhe me shumice pjese kembimi per makina. Import, eksport, etj.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKR.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerisë është **500.000(pesëqind mijë)** lekë dhe është i përbërë nga **1 kuote**.

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është tërësisht i nënshkruar, i papaguar, ndahet në 1 kuotë me vlerë, që përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë, që zotërohet nga Ortaku i vetëm i ndarë në një kuotë, si më poshtë:

Ronaldo BAJO, zotëruesi i 1 kuote, që përbën 100 % të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë, me vlerë të përgjithëshme 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të



paluajtshme apo të drejta)

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mundtë fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kerkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.



KREU III
ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organit Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.



Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e te pakten tri të katërtave te zoteruesve te kapitalit te shoqerise, qe janë pjesmarres ne mbledhje.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 10


Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator.

Administrator i shoqërisë do të jetë Z. **Ronaldo BAJO**, i biri i Izetit, i datelindjes 30.09.1997, lindur ne Durres dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit ID Nr J70930075G, i cili do të ushtrojë funksionet në këtë detyrë për një periudhë **5 vjecare me të drejtë ripërtëritje**.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkësë të çdonjërit prej ortakëve.



Tagrat e përfaqësimit të administratorit do të jenë të pakufizuara dhe çdo ndryshim i tyre njoftohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Administratorët mund të përfaqësojnë shoqërinë së bashku ose veç njëri nga tjetri dhe mund të prokurojnë të tretë për përfaqësim të tyre.

Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe ne rastet kur :

- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,



Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetete shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i

administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtmisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument

të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislativit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16

Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 3 ekzemplarë me përbajtje dhe vlera të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga ortakët e shoqërisë tregtare, nënskruajnë në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tyre orgjinale, autenticiteti i të cilës vertetohet nga Noteri.

Ngarkohet z. **Ronaldo Bajo** për depozitim të këtyre akteve pranë QKB.

ORTAKU I SHOQËRISË

Ronaldo Bajo

